



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:154146

Datë: 13.06.2024

Numri i dokumentit: 05819093

KPPP.nr. 285/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arbër Rexha, në çështjen përmbarimore të kreditorit Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale me seli në Prishtinë, rr. “Armend Daci”, nr. 1, kundër debitorit “Transportuesi” Sh.P.K., me numër unik identifikues 810427303 dhe seli në Kliqinë, Komuna e Pejës, duke vendosur sipas propozimit të debitorit të ushtruar ndaj Urdhrit Përmbarimor P.nr. 104/23, i lejuar më datë 19.06.2023, nga Përmbauesi Privat Jeton Krasniqi, me seli në Pejë, jashtë seancës me datë 13.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pabazuar propozimi i debitorit “Transportuesi” Sh.P.K., me numër unik identifikues 810427303 dhe seli në Pejë, ushtruar ndaj Urdhrit Përmbarimor P.nr. 104/23, i lejuar më datë 19.06.2023, nga Përmbauesi Privat Jeton Krasniqi.
- II. Urdhri Përmbarimor P.nr. 104/23, i lejuar më datë 19.06.2023, nga Përmbauesi Privat Jeton Krasniqi, MBETE NË FUQI.

A r s y e t i m

Përmbauesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, mbi bazën e dokumentit përmbarimor; Aktvendimit nr. 1869, të datës 01.06.2023 si dhe Aktvendimit Nr. 2263, të datës 01.07.2022, ka lejuar Urdhrit Përmbarimor P.nr. 104/23, të datës 19.06.2023, me të cilin është obliguar debitori “Transportuesi” Sh.P.K., që menjëherë pas pranimit të urdhrit, kreditorit t’ia paguaj në emër të gjobës administrative vlerën prej EUR 24,349.37, së bashku me shpenzimet e procedurës përmbarimore.

Debitori, brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim me të cilin e ka kundërshtuar në tërësi urdhrin përmbartimor, me arsyetim se nuk ka pranuar asnjëherë vërejtje apo njoftim për pagesën e detyrimeve nga ana e kreditorit. Më tej, ka theksuar se nuk mund të konsiderohet vendim përfundimtar vendimi i dhënë në procedurën administrative, pasi që ende ka dilema në praktikën gjyqësore se vendimet e organeve të pavarura a paraqesin dokumente përmbartuese. Ka shtuar se aktvendimi ka të bëjë me subjektin Transportuesi dhe jo pronarin e saj siç kreditori në propozim e ka cekur si debitor, ndërsa ka theksuar edhe se Ndërmarrja Transportuesi Sh.P.K., ka qenë pothuajse pasive në eksploatimin e rërës dhe zhavorrit dhe nuk kanë qenë të aktivizuara mekanizmat e saj punuese, prandaj kërkesa e kreditorit është e pabazuar. Për këto arsye, i ka propozuar gjykatës që të aprovojë prapësimin e debitorit, ndërsa urdhri përmbartimor të anulohet.

Kreditori, në përgjigje në prapësim ka kundërshtuar pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim me arsyetim se të njëjtat janë të pa bazuara në fakte dhe prova, dhe se debitori pasi që ka pranuar aktvendimet si tituj ekzekutiv, ndaj tyre ka ushtruar ankesë në Komisionin e Ankesave të KPMM-së, si organ i shkallës së dytë, duke qenë i njoftuar për borxhin që ka ndaj kreditorit. Ka shtuar se akti administrativ është bërë i ekzekutueshëm dhe se debitori nuk ka kryer pagesën, andaj urdhri përmbartimor është i drejtë dhe i bazuar. Për këto arsye, i ka propozuar gjykatës që të refuzojë prapësimin e debitorit si të pa bazuar, ndërsa urdhri përmbartimor të mbetet në fuqi.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes së kreditorit, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se organi përmbartues ka lejuar përmbartimin bazuar në nenin 21 të LPP-së i cili përcakton se: *“Organi përmbartues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbartimin vetëm në bazë të dokumentit përmbartues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër.”*

Gjykata ka shqyrtuar dokumentin përmbartimor përkatësisht Aktvendimet mbi bazën e të cilave përmbartuesi privat ka lejuar përmbartimin, dhe gjeti si të njëjtit, sipas nenit 22 paragrafit 1, nën paragrafi 1.2 të LPP-së, përcaktohen si dokumente përmbartuese sipas të cilave mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla. Gjykata vlerëson se Aktvendimet mbi bazën e së cilave është lejuar urdhri, i përmbajnë të gjitha elementet e përcaktuara në kuptim të nenit 27

paragrafin 1, pasi që është treguar kreditori, debitori, objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit.

Poashtu, gjykata vlerëson se në rastin konkret Aktvendimi NR. 1869 i datës 01.06.2022 dhe Aktvendimi Nr. 2263, i datës 01.07.2022, mbi bazën e të cilëve përmbaruesi privat ka lejuar përmbarimin, janë të plotfuqishëm dhe mbajnë vulën e ekzekutueshmërisë së datës 23.09.2022 dhe rrjedhimisht i plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 36, paragrafin 1 të LPP-së, sipas të cilit përcaktohet se: *“Së bashku me propozimin për përmbarim, organit përmbarues i dorëzohet edhe dokumenti përmbarues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbarueshmëris për përmbarueshmëri”*, dhe paragrafin 2 të këtij neni, sipas të cilit përcaktohet se: *“Vërtetimin për përmbarueshmërin e jep Gjykata, respektivisht organi shtetëror që ka vendosur për kërkesën në procedurën e shkallës së parë”*.

Gjykata, ka vlerësuar pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim, mirëpo gjeti se të njejtat nuk paraqesin bazë për anulimin e urdhrin përmbarimor në kuptim të nenit 71 të LPP-së, ndërsa në mbështetje të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit u vendos jashtë seancës.

Nga sa më sipër, bazuar duke u bazuar në 73, paragrafi 1 dhe 3, të LPP-së, si dhe nenin 13, paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 285/24, datë 13.06.2024

Gjyqtari
Arbër Rexha

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale në Prishtinë, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.